



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRI

11447/1
Nr. Prot

Tiranë, më 22.7/2020

URDHËR

Nr. 180, Datë 22.7.2020

“PËR SHPALLJEN E DISA NDRYSHIMEVE TË STANDARDIT NDËRKOMBËTAR TË RAPORTIMIT FINANCIAR NR. 16 “KONCESIONET E QIRASË TË LIDHURA ME COVID-19”, STANDARDIT NDËRKOMBËTAR TË RAPORTIMIT FINANCIAR NR. 3 “KOMBINIMET E BIZNESIT”, STANDARDIT NDËRKOMBËTAR TË RAPORTIMIT FINANCIAR NR. 1 “ADOPTIMI PËR HERË TË PARË I SNRF-VE”, STANDARDIT NDËRKOMBËTAR TË RAPORTIMIT FINANCIAR NR. 9 “INSTRUMENTET FINANCIARE”, STANDARDIT NDËRKOMBËTAR TË KONTABILITETIT NR. 41 “BUJQËSIA”, STANDARDIT NDËRKOMBËTAR TË KONTABILITETIT NR. 37 “PROVIZIONET, DETYRIMET DHE AKTIVET E KUSHTËZUARA”, STANDARDIT NDËRKOMBËTAR TË KONTABILITETIT NR. 16 “AKTIVET AFATGJATA MATERIALE (TOKA, NDËRTEZA, MAKINERI E PAJISJE)”

Në mbështetje të nenit 3, pika 4, të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.07.2019 “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e disa ndryshimeve të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar nr. 16 “Koncesionet e qirasë të lidhura me COVID-19”, Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar nr. 3 “Kombinimet e biznesit”, Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar nr. 1 “Adoptimi për herë të parë i SNRF-ve”, Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar nr. 9 “Instrumentet Financiare”, Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 41 “Bujqësia”, Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 37 “Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara”, Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 16 “Aktivet afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje)”.

2. Ndryshimet e SNRF nr. 16, të publikuara në vitin 2020, kanë datë efektive 1 Qershor 2020.
3. Ndryshimet e SNRF nr. 3, SNRF nr. 1, SNRF nr. 9, SNK nr. 41, SNK nr. 37 dhe SNK nr. 16, të publikuara në vitin 2020, kanë datë efektive 1 Janar 2022.
4. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

